

dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj”. Kjo e drejtë sanksionohet dhe parashikohet edhe në kërkesat nenin 6/1 të K.E.D.NJ.

Në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike”. Po kështu bazuar në ndryshimet e e bëra në nenin 25 të Ligjit nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit”, me Ligjin Nr.155/2014, ku përcaktohet se:”Avokati i Popullit, pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”.

Për sa sipër, Ju

REKOMANDOJMË :

1. Përshpejtimin e procesit gjyqësor të dosjes penale me Nr.171/15 akti, me të gjykuar të pandehurin O. H. në të ardhmen.
2. Mbi shqyrtimin dhe masat e marra në bazë të këtij rekomandimi nga ana juaj, lutemi na njoftoni me shkrim brenda 30 ditëve.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI